



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesë e Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1114/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesë e Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Gafur Orana kandidat për asamble kuvendit komunale nga subjekti politik Lidhja Demokratike e (LDK) në Ferizaj, paraqitur kundër qendrave të vendvotimeve, për shkak të parregullsive dhe manipulimit të votave gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Gafur Orana kandidat për kuvendin komunal në Ferizaj nga radhët e subjektit politik LDK.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Gafur Orana anëtarë për asamble komunale nga subjekti politik LDK dega në Ferizaj, i cili pretendon se në qendrën e votimit 2524D-Surqinë, në bazë të deklaratave të afërmë të mi unë i kam pasur rrëth 30 vota si dhe në qendrën e votimit 2532D- edhe në këtë qendër të votimit në bazë të deklaratave të familjarëve të mi unë i kam fituar rrëth 30 vota, por këto vota nuk figurojnë në rezultatet final të publikuara nga KQZ-ja.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se nga shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesit Gafur Orana nga komuna e Ferizajit. PZAP-i, vlerësoi si të pa bazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse siç pretendon pala ankuese andaj ankesë e tillë është e pa bazuar dhe në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe nenit 3.6 pikë c) të Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartëpërmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 1114/2013 më datën 06.12.2013



***Këshillë Juridik:***

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrengë 24 ( njëzetkatër) orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.